



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRI

URDHËR

NR.36, datë 13.2.2020

PËR

**NJË NDRYSHIM NË URDHËRIN NR.45, DATË 12.2.2019,  
TË KRYEMINISTRIT, “PËR CAKTIMIN E KOORDINATORIT  
SHTETËROR PËR INFORMIMIN E DIASPORËS”**

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 102 të Kushtetutës, dhe të vendimit nr.259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024 dhe të planit të veprimit”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën

URDHËROJ:

1. Pika 1, e urdhrit nr.45, datë 12.2.2019, të Kryeministrit, ndryshohet, si më poshtë vijon:  
“1. Caktimin e znj. Jona Hoxha, drejtor i Drejtorisë së Sistemeve, në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), Koordinator Shtetëror për Informimin e Diasporës Shqiptare.”
2. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
EDI RAMA